

Seances plenare

cey
/



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ___/2023

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9936, datë 26.6.2008 “PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Z. Bujar Leskaj propozon:

Në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 4/1

ISHTE: “2. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.”.

TË BËHET: “2. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik, **20 për qind për financimin e skemës së dëshmpërblimit të ish të përndjekurve politikë** dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit”.

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset e ligjit.

RELACION

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9936, datë 26.6.2008 “PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Qëllimi i këtij propozimi është ndërmarrja e një angazhimi serioz për rritjen e financimit për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë, për ta likuiduar në mënyrë përfundimtare dhe në kohë sa më të arsyeshme faturën e këtij “borxhi” të mbartur ndaj shtresës së të përndjekurve. Deri më sot, kanë kaluar 15 vite që nga viti 2007, nga data e hyrjes për herë të parë në fuqi të Ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i cili synonte likuidimin e plotë të faturës dhe përmbylljen e procesit në një hark kohor prej 8 vitesh, pra brenda vitit 2015. Me ndryshimet ligjore të pësuara, ky afat u hoq dhe, në ditët e sotme, plot 15 vjet më vonë, sipas të dhënave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, detyrimet ndaj shtresës së përndjekurve përlllogaritën në vlerën rreth 30 miliardë lekë. Kjo do të thotë se, me ritmet aktuale (30 miliardë lekë vlera totale/ 1 miliard lekë parashikuar në projekt-buxhetin e 2023, duke prezumuar dhe ndonjë rritje modeste në vitet pasuese), shtetit shqiptar i duhen rreth 25 vjet të tjerë për të përmbushur detyrimet ndaj kësaj shtrese.

Me qëllim që ky detyrim të realizohet në një afat më të shkurtër dhe subjektet e prekura të dëmshpërblehen në një kohë më të përshtatshme, përveç fondit të dedikuar, propozoj që 20 për qind e të ardhurave nga privatizimet që do të realizohen gjatë vitit 2023, të shkojnë për financimin e kësaj skeme.

Nëse sjellim në vëmendje 3 programet qeverisë të kësaj qeverie në qëndrimin e tyre kundrejt kësaj shtrese kemi:

Programi qeverisë 2013-2017, Fq 55: *“Ne marrim përsipër t’i japim fund hipokrizisë dhe abuzimit njëzetëvjeçar me të përndjekurit politikë. Ne do të bashkëpunojmë me ta për ta mbyllur me dinjitet plagën e hapur të moskompensimit të tyre...”*;

Programi qeverisë 2017-2021, Fq 21: *“Gjatë mandatit tonë të dytë do të përfundojmë dëmshpërblimin e kësaj kategorie dhe do të mbështesim integrimin dhe pjesëmarrjen e tyre shoqërore, ekonomike e politike...”*;

Programi qeverisë 2021-2025 – nuk përmendet.

Jemi në kushtet që, sot që po flasim, ky proces jo vetëm që nuk ka përfunduar, por buxheti i parashikuar dhe alokuar për dëmshpërblimin e të përndjekurve politikë po vjen me ulje nga viti në vit, krahasuar me premtimet elektorale.

Ky ndryshim për rishpërndarjen e të ardhurave nga privatizimi është i domosdoshëm, me qëllim shkurtimin e kohës së procesit të dëmshpërblimit për të përndjekurit politikë dhe njëkohësisht nuk sjell pasoja negative në ligjin në fjalë, pra Ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008, për 2 arsye:

1. Nuk e prek sasinë prej 50% të të ardhurave nga privatizimi për uljen e borxhit publik;
2. 30% e të ardhurave nga privatizimi sërish mbeten për rritjen e shpenzimeve kapitale, zë i cili ka konsiderueshëm mbështetje buxhetore çdo vit.

Të ardhurat nga privatizimi, në rast privatizimi të ndonjë sektori strategjik dhe me peshë të konsiderueshme, mund të luajnë një rol kyç dhe me impakt në përshpejtimin e zgjidhjes përfundimtare të dëmshpërblimit financiar.

Të mos harrojmë që, pesha e shumave të përfituara nga ish të përndjekurit politikë si dëmshpërblim ka qenë gjithmonë në raport gati të papërfillshëm krahasuar me PBB-në, duke mos e kaluar kurrë vlerën prej 0.14% të tij (aktualisht 1 miliard lekë i parashikuar në projekt buxhetin e vitit 2023 zë 0.05% të PBB-së).

Paralelisht me këtë propozim, kam propozuar edhe një ndryshim në Ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, me synimin për të treguar vullnetin politik për përfundimin e këtij procesi të tejzgjatur në kohë.

Ky detyrim përfaqëson një borxh publik (njëjtë si detyrimet e prapambetura, koncesionet, vendimet e arbitrazhit) dhe vijon të nënvlerësohet, pasi nuk pasqyrohet në llogaritjet zyrtare, pa marrë parasysh indeksimin e këtij detyrimi me inflacionin, me qëllim ruajtjen e vlerës reale të kompesimit.

Në kushtet kur ky proces rezulton i tejzgjatur ndër vite, sot është e nevojshme ta shohim me prioritet zgjidhjen dhe përfundimin e tij, duke zgjedhur rrugë alternative për mbështetje dhe kanalizim fondi, sikurse është rritja e buxhetit vjetor dhe përdorimi i 20 për qind të të ardhurave të privatizimit.

Bujar LESKAJ


DEPUTET I QARKUT VLORË